



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,  
Kulturë, Rini e Sport  
Mbledhja nr. 43  
Prishtinë, më 24.03. 2010 në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës  
Salla nr. N- 225

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

**Në mbledhje morën pjesë:** Drita Kadriu, Arsim Rexhepi, Heset Cakolli, Mark Krasniqi  
Enis Kervan dhe Dragan Dimiq  
**Munguan** Donika Kadaj –Bujupi dhe Memli Krasniqi.

**I ftuar:** Enver Hoxhaj – ministër i arsimit shkencës dhe teknologjisë

**Në mbledhje prezantuan:** Armend Tahirsylaj, këshilltar në MASHT, përfaqësuesi i OSBE - së, NDI - së, përfaqësuesi nga mediat përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit si dhe praktikantë të caktuar për Komisionin.

**Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë** Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu

**Mbledhjen e udhëhoqi:** Drita Kadriu zv. kryesuese e parë e Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

**Rend dite**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 16.03.2010
3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian
4. Të ndryshme

**Kryesuesja**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesja** - i njoftoi anëtarët e Komisionit se nën pikën të ndryshme të rendit të ditës të shqyrtohet Raporti me amendamente i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në mënyrë që komisioni të procedojë miratimin e tij në procedurë të mëtejme në Kuvend.

Anëtarët e komisionit u pajtuan që nën pikën të ndryshme të shqyrtohet raporti Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dhe miratuan rendin e ditës.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16.03.2010.**

**Kryesuesja** konstatoi se procesverbali i mbledhjes së 16.03.2010 u miratua pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritime Evropiane**

**Kryesuesja** tha se në bazë të Strategjisë së Planit të Veprimit për Integritime Evropiane rrjedhin disa aktivitete nga fusha e arsimit.

Komisioni ka kërkuar nga ministria e arsimit raport me shkrim lidhur me përmbushjen e Planit të Veprimit për fushën e arsimit, për numrin e personave me aftësi të kufizuara, mbi shkallën e trafikimit të fëmijëve dhe punës së tyre, shkalla e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin fillor.

**Enver Hoxhaj** ministër i arsimit shkencës dhe teknologjisë foli të përmbushjen e Planit të Veprimit për vitin 2008 si dhe për punën që po bëhet me përmbushjen e planit për vitin 2009.

Funksionimi i Këshillit Kombëtar të Shkencës, themelimi i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve janë një pjesë e Planit të Veprimit të cilat janë përmbushur gjatë vitit 2009.

Çështja e mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara është ngritur nga ministria në vitin 2008, dhe se ministria është në fazën finale të projektligjit për arsimin para universitar në të cilin projektligj përfshihen në masë të madhe edhe çështja e personave me aftësi të kufizuara.

Ministri foli edhe për qasjen në objektet shkollore të këtyre personave, si dhe për shtimin e numrit të punëtorëve arsimorë për fëmijët me nevoja të veçanta.

Sa i përket librave shkollorë në gjuhët e komuniteteve, ministri tha se vitin e kaluar është formuar një komision i cili merret me këtë çështje dhe se me pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhjet lokale së shpejti do të bëhet integrimi i teksteve shkollore.

Sa i përket teksteve shkollore në gjuhën turke dhe boshnjake është diskutuar që tekstet që nuk kanë të bëjnë me jo identitetin të merren nga shtetet tjera.

Ndërsa sa i përket komunitetit rom shkallë dhe egjiptian ministria në ditën e romeve do ta prezantojë Programin për gjuhën dhe kulturën rome, ndërsa problemi qëndron te mësimdhënësit të cilët janë në numër të vogël.

**Mark Krasniqi** tha se ministria e arsimit ka bërë hapa të rëndësishëm në përmbushjen e planit për Integritimet Evropiane si me infrastrukturë shkollore ashtu edhe në lëmi të tjera. Ai tha se secili universitet duhet të ketë tekste shkollore në gjuhën e vet.

**Heset Cakolli** përshëndeti kontributin e ministrisë sidomos për mbajtjen e javës së Shkencës, dhe kërkoi sqarim nga ministri se a do të përmbushen të dhënat e prezantuara deri në fund të vitit.

**Arsim Rexhepi** foli për rëndësime e shkollave speciale si dhe për mundësitë e shkollimit të nxënësve në këto shkolla.

Ai tha se dihet se komuniteti rom ashkali dhe egjiptas janë shqip folës, dhe se kërkoi sqarim lidhur me specifikat e kërkesat e tyre.

**Enis Kervan** - tha se disa nga tekstet shkollore në gjuhën turke nuk janë botuar. Për arsye të tirazhit të vogël të librave, shtëpitë botuese nuk angazhohen për botimin e tyre sepse çështja financiare është pengesë për botimin e librave në gjuhën turke. Çështja e hartimit të programeve dhe librave shkollor në gjuhët e komuniteteve duhet të zgjidhet dhe të kërkohet lista finale e teksteve që duhet të vijnë nga Turqia.

**Drita Kadriu**, kërkoi sqarim nga ministri se sa është bërë lidhur me trafikimin e fëmijëve, punën e tyre dhe këtë problematikë në këtë drejtim.

**Ministri Enver Hoxhaj** lidhur me çështjet e parashtruara nga anëtarët e Komisionit tha se ministria parashih që vitin e ardhshëm ta dyfishojë numrin e nxënësve me aftësi të kufizuara, kjo sipas Raportit të Fizibilitetit është prioritet i ministrisë.

Vitin e ardhshëm pritet të rritet edhe numri i psikologëve nëpër shkolla.

Sa i përket komunitetit rom ashkali dhe egjiptas ministria çdo vit krijon programe për regjistrimin e tyre në shkolla por mospjesëmarrja e tyre në shkolla është problem i natyrës tjetër.

Sa i përket çështjes së botimit të librave në gjuhën turke për shkak të interesit të botimit të tyre ministria ka marrë përsipër sponsorimin e këtyre teksteve.

**Kryesuesja** – kërkoi nga ministri një raport me shkrim në mënyrë që komisioni të raportojë në Kuvend lidhur me përmbushjen e Planit të Veprimit për fushën e arsimit, për numrin e personave me aftësi të kufizuar, mbi shkallën e trafikimit të fëmijëve dhe punës së tyre, shkalla e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar në arsimin fillor.

### **3. Të ndryshme**

#### **Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim lidhur me projektligjin për Mërgatën e Kosovës**

Komisioni shqyrtoi amendamentet e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dhe i miratoi amendamentet e propozuara nga ky Komision.

Neni 12, në vazhdim të paragrafeve 1,2, 3 dhe 6.1 shtohet teksti si vijon:

**“dhe në gjuhët e komuniteteve tjera në të cilat zhvillohet sistemi arsimor në Kosovë”**

Komisioni shqyrtoi edhe amendamentin 8 të propozuar dhe miratoi ndryshimin të përfaqësuesi i zgjedhjes së drejtorit të QKKM –së.

#### **Neni 10. 1.**

**Drejtori i QKKM zgjidhet me konkurs nga Komisioni i emëruar në përbërje prej pesë anëtarëve .**

- Një përfaqësues nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Me këto ndryshime Komisioni për arsim, përfundon shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjit për Mërgatën e Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e tij.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 12: 40

**Përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

Kryesuesja e Komisionit,

---

Drita Kadriu